



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:126700

Datë: 15.02.2021

Numri i dokumentit: 01507530

P.nr.1017/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi, me bashkëpunëtorin profesional Uran Zogaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit **A.P.** nga fshati D., Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr. 1183-14/2019 të datës 05.08.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit Shahadin Destani dhe të akuzuarit A.P., më datë **12.02.2021**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

A.P., nga i ati A., e ëma N., e vajzërisë R., i lindur më, në Podujevë, tani me banim në fshatin D., Komuna e Podujevës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i dy fëmijëve, pronar i ndërmarrjes, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Se më datë 23.03.2019 rreth orës 21:00, në fshatin Sh..., Komuna e Prizrenit, saktësisht në afërsi të lokalit “.....”, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten dhe për t’i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxitë të dëmtuarin L.A. që të kryej veprime në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që pas marrëveshjeve paraprake mes vete rreth një vize dy ditorëshe për në Republikën e Danimarkës, i njëjti merr të holla nga i dëmtuari, me arsyetimin se i duheshin për të paguar sigurimin për vizë në Ambasadën e Danimarkës në Shkup dhe nga ajo kohë largohet duke mos i hapur edhe numrin e telefonit 043/783-418, me të cilin kishte kontaktuar deri në atë kohë me të dëmtuarin, me ç’rast të dëmtuarit L. i shkakton dëm material në vlerë prej 280 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të Kodit Penal të Kosovës nr. 04/L-082 (KPK).

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura dhe neneve 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75 e 76 të KPK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **800 € (tetëqind) euro**, për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilin dënim me gjobe, i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afatin prej 15 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëher gjykata konform nenit 46 par. 3 të KPK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro llogaritet 1 (një) ditë burgim, respektivisht 40 (katërdhjetë) ditë burgim.

DËNIM ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej **1 viti (një viti)**, i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që t'ia paguajë shpenzimet e procedurës penale sa do që të bëhen ato, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **30 euro**, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari L.A. nga fshati Sh..., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtuar aktakuzën PP/II.nr. 1183-14/2019 të datës 05.08.2019, kundër të akuzuarit A.P. nga fshati D., Komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të KPK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datë 12.02.2021, në të cilin i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur, duke shtuar se është penduar për këtë vepër penale, dëshiron që të dëmtuarit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar material dhe të njëjtit publikisht i kërkoi falje që nuk ka pasur mundësi materiale që t'ia kthej të hollat, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso lloj të veprave penale.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, duke shtuar se i njëjti pranimin e ka bërë konform dispozitave ligjore të KPPRK-së, pa presion dhe në mënyrë të vullnetshme, andaj kërkoi nga gjykata që të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari më datë 23.03.2019 rreth orës 21:00, në fshatin Sh. Komuna e Prizrenit, saktësisht në afërsi të lokalit "...", me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten dhe për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër, e mashtron apo vazhdon lajthimin e personit tjetër dhe me këtë e nxitë të dëmtuarin L.A. që të kryej veprime në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që pas marrëveshjeve paraprake mes vete rreth një vize dy ditorëshe për në Republikën e Danimarkës, i njëjti merr të holla nga i dëmtuari, me arsyetimin se i duheshin për të paguar sigurimin për vizë në Ambasadën e Danimarkës në Shkup dhe nga ajo kohë largohet duke mos i hapur edhe numrin e telefonit 043/783-418, me të cilin kishte kontaktuar deri në atë kohë me të dëmtuarin, me ç'rast të dëmtuarit L. shkaktonte dëm material në vlerë prej 280 euro.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 257 të KPPRK-së. Gjithashtu, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së, dhe se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale mashtrimi, nga neni 335 par. 1 të KPK-së, dhe për këtë gjykata ka vendosur që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penal-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 dhe 74 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A.P., pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe gatishmërinë që të dëmtuarit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar material dhe premtimin që në të ardhmen nuk do të përsëritë vepra penale apo vepra të kundërligjshme. Kurse si rrethana rënduese, gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, ku vepra penale është kryer me dashje direkte, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, përkatësisht keqpërdorimi i besimit të të akuzuarit ndaj të dëmtuarit, motivet e kryerjes së veprës penale, me qëllim të përfitimit material nga veprimi i kundërligjshëm dhe sjelljen e mëparshme të të akuzuarit, pasi që i njëjti në evidencën zyrtare penale të gjykatës figuron se është i dyshuar edhe për vepra tjera penale si: rasti PP.nr.76/2018 i datës 05.11.2018, iniciuar nga Prokuroria Themelore në Pejë, pranë Gjykatës Themelore në Pejë- Dega Deçan, rasti P.nr.1268/2019 i datës 01.04.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, rasti P.nr.141/2019 i datës 28.05.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega Podujevë, rasti P.nr.4048/2019 i datës 20.09.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, rasti P.nr.4136/2019 i datës 26.09.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega Gllogoc, rasti P.nr.592/2019 i datës 01.10.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, rasti P.nr.581/2019 i datës 05.12.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Dega Podujevë, rasti PPr.371/2020 i datës 09.06.2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, rasti K.nr.2352/2020 i datës 09.09.2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, rasti PPr.nr.88/2020 i datës 09.11.2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Andaj, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen i akuzuari do të parandalohet nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloji i dënimit të shqiptuar sipas bindjes së gjykatës, është në proporcion me veprën

penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari, dhe në të ardhmen ai do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla të kundërligjshme.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale u mor në kuptim të nenit 450 dhe 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 par. 3 pika 1 të Ligjit nr.05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Penal
P.nr.1017/2019 më datë 12.02.2021

Bashkëpunëtori profesional
Uran Zogaj

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.